

V E N D I M

Nr.26, datë 14.1.1999

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.393, DATË 3.9.1992 “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE”

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.393, datë 3.9.1992, ndryshuar me vendimin nr.213, datë 28.3.1998 bëhen këto shtesa:

- a) Në lidhjen “Renditja e funksioneve sipas klasifikimit” në shkronjën A 7 shtohet emërtimi, “Kancelari i Gjykatës së Lartë”.
- b) Në lidhjen 5-II, “Niveli i pagës për punonjësit e ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore” shtohet numri rendor 2/1 me emërtimin “Kancelar në Gjykatën e Lartë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr.8362, datë 1.7.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Kasacionit dhe administrimin e shërbimeve gjyqësore”.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko